



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 48/5 Prot.

Tiranë, më 14/05 2013

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin Pro-Credit Bank sh.a.

REKOMANDIM

Nr. 06 ,datë 14/05/ 2013

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Pro-Credit Bank sh.a.**

KONSTATOVA

Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e shtetasës Zj. Vilma Hoti(Papa) administruar pranë KMDP me nr. 48/1 prot, datë 13.02.2013. Ankesa e shtetasës, subjekti i të dhënave personale, konsiston si më poshtë:

Shtetasja është kliente kredie në Pro-Credit Bankë Dega Shkodër, dhe ka qënë në vonesa për shlyerjen e kësaj kredie me një afat të caktuar ditësh. Nga Banka është dërguar tek punëdhënësi i saj BKT Shkodër një letër për t'i njoftuar ata dhe vënë në dijeni që punonjësja e tyre është në vonesë në shlyerjen e kësteve të kredisë. Gjithashtu, në shkresë kërkohet që të ndërhyet nga punëdhënësi në mënyrë që kredia të shlyhet. Sipas ankueses pas marrjes dijeni për këtë letër kjo e fundit ka kontaktuar me punonjësit përgjegjës në degën e Pro-Credit Bank Shkodër për të kërkuar sqarim në lidhje me letrën ku i është thënë se kjo quhet letër insitucionale dhe dërgohet tek punëdhënësi në rastet kur kredimarrësi nuk i përgjigjet në kohë detyrimit për shlyerjen e kredisë.

Në funksion të zgjidhjes së ankesës Komisioneri ka realizuar dy inspektime administrative: Në zbatim të Urdhërit nr.39 prot, datë 13.02.2013 është realizuar inspektimi pranë Pro-Credit Bank Shkodër, e cila është edhe banka nga e cila është dërguar shkresa për tek punëdhënësi i ankueses.

Në zbatim të Urdhërit nr. 45, datë 28.02.2013 të Komisionerit u zhvillua pranë Bankës Pro-Credit Qendra Tiranë inspektimi përkatës administrativ.

Objekti i këtij urdhëri ishte :

- ✦ Trajtimi i ankesës së Zj. Vilma Hoti(Papa) drejtuar Zyrës së Komisionerit, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga Banka Pro-Credit në lidhje me rastin e saj si kredimarrëse pranë kontrolluesit;
- ✦ Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale dhe përhapja e të dhënave të klientëve (kredimarrës) nga ana e kontrolluesit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- ✦ Mjaftueshmëria dhe proporcionaliteti i përpunimit të të dhënave personale.

Në përfundim të inspektimit administrativ pasi u realizuan takimet përkatëse me përfaqësues të kontrolluesit dhe u mbledhën provat përkatëse dhe u mbajtën procesverbalet në prani të kontrolluesit të nënshkrura rregullisht nga palët, Komisioneri vëren se:

Kontrolluesi Banka Pro-Credit sh.a ka vepruar në interes të mbledhjes së kredisë së vonuar nga ana e shtetasve e cila ka qënë në vonesa për shlyerjen e kësteve dhe në interes të përmbushjes së detyrimit ligjor nga ana e saj megjithatë, kontrolluesit që veprojnë në sektorin bankar duhet të ketë parasysh në ushtrimin e veprimtarisë së tyre edhe marrjen e masave që kanë lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve, subjekte të të dhënave personale.

Ruajtja e konfidencialitet të klientit është edhe një detyrim ligjor i Bankave i parashikuar shprehimisht në legjislacionin bankar.

Sa më sipër Banka duhet në cdo rast të respektojë dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar në të gjithë veprimtarinë e vet.

Debitorja në rastin konkret nuk është informuar në lidhje me faktin e përhapjes së informacionit tek personat e tretë që është punëdhënësi i saj (Banka Kombëtare Tregtare). Në nenin 18 parashikohet detyrimi për informim i subjektit të të dhënave personale në lidhje me të dhënat e tij personale. Kontrolluesi kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit etj. Gjithashtu, në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale të marra nga subjekti i të dhënave ai është i detyruar të informojë subjektin nëse dhënia e të dhënave tek palë të treta është e detyrueshme apo vullnetare.

Sipas Direktivës 95/46 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës 24 tetor 1995 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të të dhënave” parashikohet se:

“Duke qënë se përpunimi i drejtë i të dhënave nënkupton se subjekti i të dhënave mund të jetë në dijeni të përpunimit dhe, kur të të dhënat mbledhen prej tij, duhet ti jepet një informacion i saktë dhe i plotë duke mbajtur parasysh rrethanat e mbledhjes. Duke qënë se disa përpunime bëhen me të dhëna të cilat kontrolluesi i ka mbledhur drejtpërdrejt prej subjektit të të dhënave; se, akoma më tej, të dhënat mund ti përhapen në mënyrë të ligjshme një pale të tretë, edhe pse kjo përhapje nuk ishte parashikuar në kohën kur të dhënat u mbledhën nga subjekti i të dhënave; se, në të gjitha rastet, subjekti i të dhënave duhet të informohet në momentin e regjistrimit të të dhënave ose maksimumi kur këto të dhëna i përhapen për here të pare një pale të tretë;

Gjithashtu, Neni 18/ 4 i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar parashikon se: Kontrolluesi kur përpunon të dhëna në bazë të një detyrimi ligjor, në lidhje me ushtrimin apo mbrojtjen e të dhënave të ligjshme është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave rreth përpunimit të të dhënave të tij.

Pra, duhet paraprakisht një informim i plotë për të gjitha veprimet e ndërmara nga kontrolluesi përpara se përpunimi të vijojë. Subjekti i të dhënave në këtë rast nuk është informuar, çfarë e bën Pro-Credit Bank të jetë në shkelje të këtyre dispozitave dhe në cënim të së drejtës së subjektit për privatësi.

Në këto kushte, në përfundim të këtij inspektimi administrativ në funksion të trajtimit të ankesës së zj.Vilma Hoti (Papa), duke u nisur nga analizimi i mëtejshëm i dokumentacionit të mbledhur nga kontrolluesi dhe në zbatim të neneve 5, 6, 18, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr 20, datë 03.08.2012 “Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar” të Komisionerit dhe neneve 107-109 të K.Pr.Administrative:

REKOMANDOJ

1. Kontrolluesi, Pro-Credit Bank sh.a gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij përsa i përket procedurës së vjeljes së kësteve të kredive nga debitorët në vonesë duhet të ketë parasysh dispozitat e Ligjit nr. Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në mënyrë specifike dispozitat që kanë lidhje me të drejtën e informimit të subjekteve;
2. Kontrolluesi, Pro-Credit Bank sh.a në veprimet e mëtejshme bankare duhet të respektojë dhe të mbajë parasysh në cdo rast dispozitat e Ligjit nr. Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr 20, datë 03.08.2012 “Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar” të Komisionerit;
3. Procedurat paraprake, për venien në dijeni të kredimarrësit ose përhapjen e të dhënave të tij apo çdo informacioni në lidhje me kredinë dhe vonesat në shlyerjen e saj, që mendohen të aplikohen përpara kalimit të subjektit në “Regjistrin e Kredive të Këqija”, të parashikohen në mënyrë eksplicite në Rregulloren e Brendshme, si dhe në Kontratën e lidhur me Kredimarrësin;
4. Për procedurat paraprake të miratuara, subjekti i të dhënave (kredimarrësi) të informohet jo vetëm për detyrimet dhe pasojat kontraktuale, por edhe në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që përfshihen në zbatimin e këtyre procedurave;
5. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit... “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

